



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E PERFORMANCËS

Nr. _____ prot.

Tiranë _____ . 2025

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORË

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) në mbështetje Ligjit nr.69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të VKM, nr. 98, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”; dhe të rregullores së brendshme nr. 492, datë 30. 07. 2020 “Për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm”; në zbatim të planit të veprimtarive të ASCAP-it, shpall thirrjen për bashkëpunëtorë që mund të angazhohen në lidhje me vlerësimin e performancës së sistemit arsimor parauniversitar.

Bashkëpunëtorët duhet të përmbushin këto kërkesa:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë me kohë të plotë në një nga degët: Mësuesi, shkenca matematike, shkenca kompjuterike ose shkenca ekonomike.
2. Të kenë të paktën 3 vjet eksperiencë pune në arsim ose në administratën publike.
3. Të kenë përvojë paraprake në një ose disa nga veprimtaritë e mëposhtme:
 - Hartimin dhe shkrimin e raporteve dhe komunikimin e gjetjeve në mënyrë të qartë dhe koncize;
 - Përvojë e mëparshme në mësimdhënie ose administrim arsimor, si dhe në hartimin ose vlerësimin e politikave arsimore;
 - Bashkëpunime me ASCAP-in dhe institucione të tjera të varësisë së MAS-it, për realizimin e veprimtarive të tyre në mbështetje të edukimit në arsimin parauniversitar;
 - Njohuri të mira mbi politikat dhe praktikat arsimore në nivel kombëtar dhe evropian;
 - Aftësi për të kryer kërkime të thelluara për të vlerësuar performancën arsimore dhe për të propozuar përmirësime.
 - Njohuri të mira në analizën statistikore dhe përpunimin e të dhënave duke përdorur programet kompjuterike dhe aftësi të mira digjitale.
4. Të kenë aftësi bashkëpunuese dhe aftësi të punës në grup.
5. Të kenë njohuri në gjuhë të huaj (preferohet gjuha angleze).

Kandidatët duhet të dorëzojnë CV-në, fotokopje të diplomës dhe fotokopje të dokumentit të identitetit dhe certifikatave të trajnimit apo kualifikimit pranë sekretarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), në adresën: *Rruga "Naim Frashëri"*, Nr.37, Tiranë, ose me e-mail sekretaria@ascap.edu.al brenda datës 28.02.2025, ora 14.00.

Faleminderit!